



NJOFTIM PËR SHTYP

Kanë kaluar kohërat kur energjëtika nënkuptonte vetëm prodhues, transmetim dhe konsumator. Tani kemi sistem dinamik, ku të gjithë duhet të japim maksimumin për ta mirëmbajtur dhe për ta mundësuar dërgesën stabile të energjisë elektrike për qytetarët- theksoi Aco Ristov, kryetari i Komisionit Rregullator të Energjetikës, të Shërbimeve të Ujit dhe të Shërbimeve të Menaxhimit me Mbeturina Komunale (KRrE), i cili së bashku me anëtarët e komisionit mbajti mbledhje me menaxhmentin e EVN Maqedoni.

"Ne jemi pjesë e sektorit, ku qasja strategjike është e domosdoshme dhe është thelbësore të vepohet një vit më herët, pasi proceset janë dinamike. Pres të vazhdoni me investimet, të cilat do të nënkuptojnë ngritjen e cilësisë së shërbimit për qytetarët. Në periudhën në vijim do të kemi shumë sfida për tu përgatitur për lidhjen e tregut vendor me atë evropian", theksoi Aco Ristov, kryetar i KRrE-së.

Qasja e drejtë ndaj konsumatorëve dhe mbështetja e investimeve është parimi, në bazë të së cilit rregulatori do të vazhdojë të veprojë përmes bashkëpunimit me EVN Maqedoni.

„Gjatë këtyre 20 viteve që EVN Maqedoni është aktive në tregun tonë, ndodhën shumë ndryshime, si në aspektin teknik, ashtu edhe në avancimin e shërbimeve. Tani më kemi arritur në fazën kur digjitalizimi dhe inteligjenca artificiale do të na çojnë tutje", potencoi Aco Ristov, kryetar i KRrE-së.

10.6.2026



ул. Македонија бр. 25, палата Лазар Поп-Трајков - 6^{тм} спрат • 1000 Скопје,
Република Северна Македонија
Централа 02 3233-580 • Факс: 02 2556 004 • www.erc.org.mk • e-mail: erc@erc.org.mk

Rr. Maqedonia nr. 25, pallati L Lazar Pop-Trajkov – kati i 6 • 1000 Shkup,
Republika e Maqedonisë së Veriut
Qendra 02 3233-580 • Faks: 02 2556 004 • www.erc.org.mk • e-mail: erc@erc.org.mk